



2
0
2
4

BULETINI

KORRIK



Mbahet takimi i radhës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB, kryesuar nga Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, sot ka mbajtur takimin e tretë të rregullt për këtë vit, në të cilin u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.

Nënkryetari z. Diamant Bytyqi, ka njoftuar anëtarët e KKSBB-së për çështjet aktuale dhe në pika të shkurtra rreth projekteve në Kornizën Afatmesme Buxhetore, e cila ka kaluar në seancën e fundit të kuvendit. Ai ka shtuar se këtë vit Komuna e Lipjanit ka marrë raportin e pamodifikuar nga Auditori i Përgjithshëm, që është vlerësimi më i lartë.



Kryetari Ahmeti nënshkruan kontratat për subvencionimin e Klubeve Sportive në Lipjan

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar kontratat për subvencionimin e klubeve sportive, së bashku me përfaqësuesit e tyre, ku me këtë rast ai theksoi përkushtimin për mbështetjen dhe promovimin e sportit në Lipjan, duke u uruar suksese të mëtejshme të gjitha klubeve. Përfaqësuesit e klubeve sportive shprehën mirënjohjen e tyre të thellë ndaj Kryetarit Ahmeti, duke e cilësuar këtë mbështetje si një ndihmë të çmuar dhe shumë të mirëpritur.

Komuna e Lipjanit, nëpërmjet thirrjes së fundit publike, ka ofruar përkrahje financiare në vlerë prej 77,000.00 euro për 17 klube sportive që marrin pjesë në gara zyrtare në federatat përkatëse.



Drejtori për Bujqësi z. Rexhep Rexhepi, ka vizituar fermerët e Komunës së Lipjanit për të ndjekur nga afër procesin e korrje-shirjeve.

Drejtori Rexhepi ka theksuar se viti 2024 është viti më i mirë për fermerët e komunës së Lipjanit.

“Përkushtimi dhe puna e palodhur e fermerëve tanë po shpërblehen me një prodhimtari të lartë dhe kjo është një dëshmi e fortë e potencialit të bujqësisë në Komunën e Lipjanit,” tha drejtori Rexhep Rexhepi.

Ai ka theksuar se aktualisht në Komunën e Lipjanit, sipas shënimeve të drejtoratisë së bujqësisë, janë mbjellur 4100 hektarë grurë. Në terren po operojnë mbi 120 autokombanja dhe rendimentet për këtë vit vlerësohen të jenë rreth 5500 deri 6000 kg grurë për hektar.

Sipas rekomandimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, çmimi i korrje-shirjes për një hektar në këtë vit është 130 euro.



Komiteti për Komunitete zhvillon mbledhjen e 28-të me radhë

Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit u mbajt mbledhja e 28-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi Skender Bikliqi. Në këtë takim, anëtarët e komitetit shqyrtuan pikat e rendit të ditës, duke u përqendruar në çështjet kyçe që prekin komunitetet jo shumicë.

Në këtë mbledhje mori pjesë edhe Drejtori për Infrastrukturë z. Sead Aliu, i cili informoi të pranishmit rreth zhvillimeve të fundit në infrastrukturën lokale që përfshijnë projektet në zonat ku banojnë komunitete jo shumicë në territorin e Komunës së Lipjanit. Ai theksoi rëndësinë e përmirësimit të infrastrukturës për këto komunitete, duke prezantuar detajet dhe ecurinë e projekteve të ndryshme që janë në zhvillim e sipër.



Komuna e Lipjanit shpërndanë 273 freza për fermerët

Komuna e Lipjanit ka shpërndarë 273 freza për fermerët përfitues në kuadër të procesit të subvencionimit me mekanizëm bujqësor nga Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Kryetari i komunës, z. Imri Ahmeti, gjatë procesit të shpërndarjes së frezave tha se ky lloj subvencionimi ka për qëllim zhvillimin dhe avancimin e bujqësisë në Lipjan dhe se kjo nuk do të jetë ndihmesa e fundit për bujqit e Lipjanit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Ambasadorin e Italisë në Kosovë, z. Antonello De Riu.

Gjatë këtij takimi, ata diskutuan mbi nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe kulturor në komunën e Lipjanit. Kryetari Ahmeti e falënderoi ambasadorin italian për vizitën dhe shprehu mirënjohje ndaj popullit italian për mbështetjen e vazhdueshme ndaj shtetit të Kosovës.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij kanë pritur në takim përfaqësues të USAID-it nga projekti “Integriteti i Komunave të Kosovës”, të cilët prezantuan rezultatet e arritura nga Komuna e Lipjanit 6 mujorin e parë të vitit 2024 në indikatorët e gradimit për komunat partnere.

Kryetari z. Imri Ahmeti ka falënderuar ekipin e USAID-it për bashkëpunimin dhe asistimin në fushat e caktuara të projektit ku ka pasur impakt dhe një progres të shtuar në menaxhim sa më efikas dhe sipas këtyre rezultateve që u prezantuan sot po shifet që ka një progres të shtuar në këto fusha.



Panairi i Biznesit për Zhvillimin Gjithëpërfshirës Ekonomik

Në sheshin “Adem Jashari”, Komuna e Lipjanit ka organizuar Panairin e Ndërmarrësisë në bashkëpunim me Aktivitetin e USAID-it për Zhvillimin Gjithëpërfshirës Ekonomik, i cili zbatohet nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF). Në këtë panair morën pjesë bizneset e udhëhequra nga gratë dhe minoritetet e Komunës së Lipjanit.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, theksoi se ky panair ka për qëllim ekspozimin e prodhimeve vendore nga bizneset e udhëhequra nga gratë.



Mbahet edicioni i tretë i panairit P-GJASHT në Lipjan

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Kryetaren e Komunës së Avesta znj. Blerta Krenzi, e cila përfaqëson partinë Social Demokrate, në Suedi.

Kryetari Ahmeti është shprehur i lumtur që shqiptarët nga Kosova kanë arritur suksese edhe në shtetet perëndimore.

“Ndihe me të vërtetë mirë kur shoh shqiptarë nga Kosova, e veçanërisht nga komuna e Lipjanit, që arrijnë suksese të jashtëzakonshme në shtete evropiane,” tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ndërsa kryetarja Krenzi fillimisht ka falënderuar kryetarin Ahmeti për pritjen dhe respektin e treguar ndaj saj.

“Fillimisht dua të ju falënderoj për mikpritjen e bërë sot dhe njëherësh po ndihem mirë që gjendem në komunën e Lipjanit, pasi edhe unë jam me prejardhje nga Lipjani, gjithashtu po e shoh Lipjanin si një qytet shumë të mirë dhe të rregulluar”, tha kryetarja znj. Blerta Krenzi.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, së bashku me Kryesuesin e Kuvendit z. Daut Azemi, dhe Drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit znj. Anila Reçica Llugiqi, sot kanë marrë pjesë në punëtorinë Podium e cila po organizohet në Lipjan.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se organizime të tilla ndihmojnë të rinjtë që të zhvillojnë aftësitë e tyre në fusha të ndryshme të cilat kanë ndikim të madh në zhvillimin e karrierës së tyre.



Nënkryetari për Komunitete në Komunën e Lipjanit z. Lulzim Qerimi, ka pritur në takim znj. Elizabet Gowing, Kryesues e Grupit Punues institucional për parandalimin e martesave të hershme të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Në takim prezent ishin edhe përfaqësues nga Policia e Kosovës dega në Lipjan, zyrtar komunal, nga QPS dhe pjesëmarrës të tjerë që merren me problematikat e kësaj fushe.

Nënkryetari për Komunitete z. Lulzim Qerimi, lidhur me këtë dukuri ka ofruar mbështetje dhe bashkëpunim institucional që nëpërmes mekanizmave komunal të jenë të angazhuar që kjo dukuri të eliminohet në shoqërinë tonë në përgjithësi.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi së bashku me drejtorin e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, z. Shkelzen Hajdini, kanë pranuar nga shoqata “Swiss Barakah”, një donacion me kondicionerë për Qendrën e Mjekësisë Familjare Magurë dhe Ambulancën Familjare në Dobrajë të Madhe.

Nënkryetari Bytyqi ka falënderuar shoqatën “Swiss Barakah”, për donacionin, duke thënë se donacionet e tilla janë të rëndësishme sepse ndikojnë në shëndetin e pacientëve dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin shëndetësor që punojnë në këto dy qendra të mjekësisë familjare.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim znj. Enilda Zeqiri, e cila ka fituar vendin e parë në kuizin olimpik të organizuar nga Komiteti Olimpik.

Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti, është shprehur i lumtur për sukseset e lipjanasve e në veçanti të Enildës, e cila vazhdimisht na bën krenarë të gjithëve me sukseset e njëpasnjëshme.

Kryetari Ahmeti po ashtu ka ndarë një subvencion në vlerë prej 1500 euro nga DKRS, kategoria e dedikuar për sportistë.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Burim Rustemi, kanë vizituar Njësitin e Zjarrëfikësve në Lipjan ku kanë pranuar disa pajisje shtesë nga komuna të cilat do të jenë në shërbim të punës së tyre.

Nënkryetari z. Diamant Bytyqi ka falënderuar zjarrfikësit për përkushtimin dhe guximin e tyre në mbrojtjen e jetëve dhe pasurive tona nga zjarret.

Në të njëjtën kohë përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit kanë apeluar tek të gjithë qytetarët që të shtojnë kujdesin e duhur të mos lejojnë ndezjen e zjarreve tek hamullore (sernishtat) e në vende tjera sepse ndezja e zjarreve jo vetëm që dëmton tokën dhe ndotë ambientin por dëmton edhe florën, faunën dhe rrezikon jetën e njerëzve e pronës, na duhet ndihma e të gjithë qytetarëve të mos e lejojmë këtë.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 28-të me radhë

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 28-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Gjatë këtij takimi, auditori i brendshëm komunal ka informuar përfaqësuesit e KPF-së rreth raportit të zyrës kombëtare të auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2023 të cilin edhe këtë vit Komuna e Lipjanit ka marrë raportin e pamodifikuar nga Auditori i Përgjithshëm, që përfaqëson vlerësimin më të lartë të mundshëm.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve për secilën pikë, anëtarët e KPF-së aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të enjten, më 25 korrik 2024.



Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka mbajtur mbledhjen e 32-të

Në Kuvendi e Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi z. Daut Azemi, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 32-të me radhë, në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës pas miratimit të rendit të ditës nga ana e anëtarëve të Kuvendit.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Me vazhdimin e kësaj seance janë diskutuar edhe raportet si ai shpenzimeve dhe i të hyrave Janar-Qershor 2024, raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin 2023 dhe plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar në raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2023, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit si dhe raporti vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me Drejtorin për Shëndetësi, z. Shkëlzen Hajdini, dhe Zëdhënësen, znj. Hyra Bytyqi, kanë pritur në takim Zëvendës shefen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, znj. Cornelia Taylor.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se Komuna e Lipjanit ka finalizuar me sukses Strategjinë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027 dhe Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, të cilat janë dokumente shumë të rëndësishme.



Drejtori për Zhvillim Ekonomik z. Valon Pacolli, së bashku me Shefin e Kabinetit z. Avni Jashari, kanë marrë pjesë në takim të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, ku është bërë prezantimi i masterplanit për zhvillim turistik të Majës së Goleshit, i cili është përgatitur nga kompania e specializuar me seli në Francë, EPODE.

Drejtori Pacolli, tha se përmes këtij masterplani synojmë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, sepse zhvillimi i potencialit turistik në këtë lokalitet është objektiv strategjike e Komunës së Lipjanit.



Po fillon Festivali Mërgata Fest & Sports
Një javë plot argëtim, filluam me aktivitete për fëmijë, të mbushura me argëtim, aktivitetet përfshijnë: shfaqje filmi nën yje , gjuajtje me hark , tërheqje litarit dhe gara vrapimi , park inflator për argëtim pa fund , dhe bilardo e aktivitete të tjera zbavitëse .



Dita e dytë e Festivalit Mërgata Fest & Sports ka vazhduar me aktivitete të shumta sportive.

Energjia e krijuar nga pjesëmarrësit të cilët u përfshinë në aktivitete sportive, duke shijuar lojëra të ndryshme si shah , ping pong , flipper dhe basketboll, krijuan një atmosferë të jashtëzakonshme duke sjellë emocione garuese për të gjithë pjesëmarrësit.



Komuna e Lipjanit fillon hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën e ardhshme 5 vjeçare

Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit, është mbajtur takimi i parë në mes përfaqësuesve të komunës, përfaqësuesit të MAPL-së dhe kompanisë së angazhuar për përkrahje profesionale për fillimin e hartimit Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën e ardhshme 5 vjeçare.



Java e mërgatës ka sjellur gjallëri dhe energji të jashtëzakonshme të shtigjet e ecjes në Lipjan, të cilat u shëndrruan në atraksion të aktiviteteve sportive edhe në ditën e tretë të këtij festivali.


Të rinjtë kanë qenë pjesë e aktiviteteve të ndryshme si lojërat rekreative për fëmijë, ping pong, flipper, street ball dhe volleybeach.



Nata e katërt e sportit në kuadër të festivalit Mërgata Fest & Sports u përmbyll me aktivitete të shumta sportive të cilat u shëndruan në atraksion të këtij festivali.

Për katër ditë me radhë lipjanasit shijuan aktivitete të ndryshme rekreative dhe sportive si: shfaqje filmi nën yje , gjuajtje me hark , tërheqje litarit dhe gara vrapimi , park inflator për argëtim pa fund , bilardo , volleybeach, movie night , ping pong , basketball scoreboard, badminton, flipper dhe shah.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë